

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
 MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE TRANSPORTIT  
 MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE I TRANSPORTA  
 MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND TRANSPORTATION

Njësi Org. Nr. i Prot.  
 Org. Jedinica Broj Prot.  
 Org. Unit Prof. No.

01 7408

Xefi i Departamentit Datum:  
 Broj Stranica 11.07.19  
 No. Stranica

PRISHTINE/A



Republika e Kosovës  
 Republika Kosova - Republic of Kosovo  
 Qeveria - Vlada - Government  
 Ministria Infrastrukturës dhe Transportit  
 Ministarstvo Infrastrukture i Transporta  
 Ministry of Infrastructure and Transportation

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
 MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS  
 MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE  
 MINISTRY OF INFRASTRUCTURE

Nënsia Org. Nr. i Prot.  
 Broj Prot. 480/19  
 Prot. No.

KM-MIT  
 2+slit  
 Datum: 11-07-19  
 Date:

BTINE/A

Ministri Infrastrukturës dhe Transportit, në mbështetje të nenit 145 (paragrafit 2), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) dhe neni 38 (paragrafi 3) të rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës të Kryeministrit dhe Ministrave (22.03.2011), Rregulloren nr. 26/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr. 02/2011 Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës të Kryeministrit dhe Ministrave, nenit 84 dhe 131 të Ligjit nr. 05/L - 031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazta Zyrtare Nr. 20/21 qershor 2016), nenit 5 dhe 21 Ligjit nr. 04/L - 179 për Transportin Rrugor, Udhëzimin Administrativ nr. 06/2016 për plotësimin e udhëzimit administrativ nr. 09/2013 për Rrjetin e Linjave dhe Rendit të Udhëtimit të Transportit Ndërrurban të Udhëtarëve me Autobus, dhe rekomandimit të komisionit të caktuar me vendimin nr.5517 të dt.23.05.2019, nxjerr këtë:

### VENDIM

**Refuzohet** ankesa nr. prot. 4820 të dt. 07.05.2019 e parashtruar nga operatori transportues NTP "DELI" nga Novobërda, ndaj vendimit nr.4163 të dt.19.04.2019 për refuzimin e kërkesës për marrjen e nisjes në relacionin Gjilan-Ferizaj, për nisjen në ora 06:40 me kthim në ora 09:00.

### Arsyetim

Komisionit i emëruar nga Ministri Infrastrukturës dhe Transportit, me vendimin nr. prot. 5517 të datës 23.05.2019, pas shqyrtimit të ankesës nr. prot. 4820 të dt. 07.05.2019 e parashtruar nga operatori transportues NTP "DELI" nga Novobërda, ndaj vendimit nr. 4163 të dt. 19.04.2019 për refuzimin e kërkesës për marrjen e nisjes në relacionin Gjilan - Ferizaj, për nisjen në ora 06:40 me kthim në ora 09:00, dhe pas vlerësimit të dosjes të aplikimit, kushteve për aplikim në shpalljen publike dhe procesverbaleve të komisionit të caktuar nga Ministri Infrastrukturës dhe Transportit me vendimin nr. prot. 2259/18 të datës 06.03.2019 për vlerësimin e aplikacionit, vlerësojmë se komisioni ka bërë vlerësim të drejtë të aplikacionit ashtu që operatori në fjalë nuk i ka plotësuar kushtet sipas pikës (3) të shpalljes publike nr. 1643 dt. 21.02.2019 dhe paragrafit (1) nën paragrafi 1.7 të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ nr. 09/2013 për Rrjetin e Linjave dhe Rendin e Udhëtimit të Transportit Ndërrurban të Udhëtarëve me Autobus i cili kriter është dhënë edhe në shpjegimin për mënyrën e aplikimit në shpalljen publike nr.1643 dt. 21.02.2019, pasi që i njëjti në dosje të aplikimit ka prezantuar 3 (tre) autobus të certifikuar ndërsa sipas evidencës në DTT të konstatuar nga komisioni sipas vendimin nr. prot. 355/18 të datës 06.04.2018 për vlerësimin e aplikacionit i njëjti posedon kontratë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit në Transportin Humanitar.

Andaj në bazë të kësaj që u tha më lartë vendimi është marrë si në dispozitiv dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Këshilla Juridike:**

Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroi pari në Gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**I dërgohet:**

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës të Sekretarit të Përgjithshëm;
- Parashtruesit të kërkesës;
- Departamentit të Transportit Tokësor;
- Zyrës së Arkivit të MI -së.

